



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 659/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.10.2019, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e shoqërisë “Fedos” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr.REF-29386-07-04-2019, me objekt: “*Hemokultura*”, Loti 3, me fond limit 4 104 500 lekë pa tvsh, zhvilluar ne daten 29.07.2019 nga autoriteti kontraktor Qendra Spitalore Universitare “Nene Tereza”.

Ankimues: “Biochem NRP” sh.p.k
Rr. “Sh.Fusha”, P. “Al Konstruksion”, K.I, Farkë, Selitë, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Qendra Spitalore Universitare “Nene Tereza”.
Rruga e Dibres Nr. 372, Tirane

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 05.07.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr.REF-29386-07-04-2019, me objekt: “*Hemokultura*”, Loti 3, me fond limit 4 104 500 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 29.07.2019 nga autoriteti kontraktor Qendra Spitalore Universitare “*Nene Tereza*”..

II.2. Në datën 27.08.2019 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si më poshtë:

- | | |
|---------------------------|-------------------------|
| 1. “Fedos” sh.p.k | 1.328 lekë, kualifikuar |
| 2. “Biochem NRP” sh.p.k. | 1.837 lekë, kualifikuar |
| 3. “OES Distrimed” sh.p.k | 2.100 lekë, kualifikuar |

II.3. Në datën 28.08.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, nëpërmjet të cilës kundërshton kualifikimin e shoqërisë “Fedos” sh.p.k në procedurën e prokurimit. Konkretisht pretendohet si vijon:

“Operatori ekonomik "Biochem NRP" shpk operon ne tregun e furnizimit me material mjeksore prej disa vitesh dhe nisur nga pervoja disa vjecare dhe serioziteti, kemi marre pjese ne proceduren e prokurimit te zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor Qendra Spitalore Universitare "Nene Tereza", Tirane, me objekt “Blerje materiale mjekesore per Sherbimin e Labororit te Mikrobiologjise”, ne QSUT per vitin 2019-2020 (per 12 muaj) e ndare ne Lote, Loti 3 Hemokultura". Fondi limit Loti 3 me vlere 4.104.500 (kater milion e njeqind e kater mije e peseqind)leke pa TVSH REF-2~386-07-04-2019, zhvilluar me daten 29.07.2019ora 10.00.

Komisioni i vleresimit te ofertave realizoi perfundimin e vleresimit per tenderin Blerje materiale mjekespre per Sherbimin e Labororit te Mikrobiologjise, ne QSUT per vitin 2019-2020 (per 12 muaj) e ndare ne Lote, Loti 3 Hemokultura (Faza e vleresimit te tenderit), ne rruge elektronike me date 27.08.2019 ora 09:23 (date dhe ore e sistemit te prokurimit publik), ku eshte komunikuar se ne kete procedure kan marre pjese 3 operatore ekonomike, ku jane kualifikuar 3 operatore ekonomike ofertues. Renditja dhe ofertat sipas vleres se shumatores paraqitet si me poshte:

<i>“Fedos” sh.p.k</i>	<i>1.328 lekë,</i>
<i>“Biochem NRP” sh.p.k.</i>	<i>1.837 lekë,</i>
<i>“OES Distrimed” sh.p.k</i>	<i>2.100 lekë,</i>

Kundershtojme kualifikimin e operatorit ekonomik FEDOS shpk sepse ky operator ka dorezuar oferte anomalisht te ulet, duke e argumentuar si vijon:

Ne DST,ne SPE Loti 3 "Hemokultura" me REF-29386-07-04-2019, ne udhezimin per operatoret ekonomike, faqe 17 pika 3.3 Ofertat anomalisht te ulet percaktohet se:

"Ne rastin kur jane te vlefshme tre ose me shurne oferta, ne perputhje me nenin 56 te LPP-se, oferta vleresohet anomalisht e ulet nese vlere e saj do te jete me e vogel se 85 perqind e mesatares se ofertave te vlefshme. Nese nje apo disa oferta vleresohen si anomalisht te uleta, komisioni i vleresimit te ofertave duhet te kerkoje sqarime nga ofertuesit, perpara se te marre vendim per kualifikimin ose jo te tyre, ne perputhje me nenin 56 te LPP.

Ne cdo rast ofertuesi ka detyrimin te argumentojte dhe dokumentojte me prova shkresore sqarimet mbi elementin/elementet e vecante te ofertes, ne perputhje me kerkesat e nenit 56 te LPP, sqarohet zbatimi i formulae per rastin kur kemi tre ose me shume oferta te vlefshme." Referuar vleresimit te ofertave nga KVO e Qendres Spitalore Universitare Nene Tereza jane tre oferta te vlefshme si me poshte:

<i>“Fedos” sh.p.k</i>	<i>1.328 lekë,</i>
<i>“Biochem NRP” sh.p.k.</i>	<i>1.837 lekë,</i>
<i>“OES Distrimed” sh.p.k</i>	<i>2.100 lekë,</i>

Ne perputhje me nenin 56 te LPP formula e perllogarltjes se nje oferte anomalisht te ulet (ne rastin kur kemi tre ose me shume oferta te vlefshme) eshte :

0- Oferta

Mo - Mesatarja e Ofertave te vlefshme n - Numri i Ofertave te vlefshme

ZM- Zbritja e Mundshme

$ZM = 85\% Mo$

Vlera e Ofertes qe vleresohet $< ZM$, si rrjedhim Oferta eshte Anomalisht e Ulet. Ne rastin e loti 3 "Hernokultura" me REF-29386-07-04-2019, kemi

$O1 = 1.328$

$O2 = 1.837$

$O3 = 2.100$

$Mo = O1 + O2 + O3 + \dots On / n$

$Mo = 1.328 + 1.837 + 2.100 = 5.265 / 3 = 1.755$

$ZM = 85\% 1.755 = 1.491,75$

Vlera e Ofertes qe vleresohet $1.328 < ZM 1491.75$

Pra vlera e ofertes se operatorit ekonomik FEDOS eshte 1.328 me e Vogel se ZM, rrjedhimisht kjo oferte eshte anormalisht e ulet dhe kjo oferte duhet te skualifikohet.

Bazuar ne nenin 1 dhe nenin 2 te LPP, ne te diet percaktohet perkatesisht: "Qellimi i ketij ligji eshte: [...] te siguroje nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithë operatorët ekonornike, pjesernarres ne procedurat e prokurirnit publik"; "Perzgjedhja e fituesve te kontratave publike realizohet ne perputhje me keto parime te pergjithshme: a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabarte i ofertuesve ose kandidatëve; b) transparence ne procedurat e prokurimit; c) barazi ne trajtimin e kerkesave dhe te detyrimeve, qe u ngarkohen ofertuesve ose kandldateve",

Nga ky argument i paraqitur i cili eshte mbeshtetur ne fakte e baze ligjore te cituar me lart, del se oferta e dorezuar nga operatorit ekonomik "FEDOS" eshte oferte anomalisht e ulet, kostatim te cilin Autoriteti Kontraktor duhet ta kishte zbatuar, prandaj kundershtojme si rast i paprecedent kualifikimin e ofertes se operatorit ekonomik "FEDOS" duke argumentuar si me poshte:

Operatorët ekonomike jane te detyruar te pergatisin ofertat, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentat e tenderit dhe ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto dokumenta duhet te refuzohen si te papranueshme. Pranimi, shqyrtimi dhe vleresimi i ofertave duhet te behet ne zbatim te dokumenteve te tenderit, pasi ne rast te kundert do te cenonte parimin e barazise ne procedurat e prokurimit. Zbatimi i parimit te transparences barazise, dhe mosdiskriminimit jane garancite kyce ndaj ofertuesve qe ofron kuadri ligjor ne fuqi.

Operatori ekonomik "FEDOS" Sh.p.k ka paraqitur oferte anomalisht te ulet, referuar ligjit Nr.9643, date 20.11.2006, (i ndryshuar), Neni 56 "I.Kur autoriteti kontraktor veren se nje ose me shume oferta per kontratat e mallrave, puneve apo sherbimeve jane anomalisht te uleta, ai, perpara se te vazhdoje me procesin e vleresimit te ofertave, i kerkon operatorit ekonomik perkates te paraqese me shkrim dhe brenda 3 diteve pune, shpjegime per elemente te vecanta te ofertes, per: a) anen ekonomike te rnetodes se ndertlrnit, procesit te prodhimit ose te sherbimeve te ofruara; b) zgjidhjet teknike te ofruara dhe ose ndonje kusht favorizues te jashtezakonshem, qe ka ofertuesi per kryerjen e punimeve, per furnizimin e mallrave apo te sherbimeve: c) origjinalitetin e puneve, mallrave apo te sherbimeve, te propozuara nga

ofertuesi; zbatueshmerine e detyrimeve, qe lidhen me mbrojtjen ne pune dhe kushtet e punes, ne vendin ku do te kryhet puna, sherbirni apo ku do te sigurohet furnizimi. 2. Autoriteti kontraktor i verifikon keto elemente duke u keshilluar me ofertuesin dhe ne baze te informacionit te paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzoje oferten, kur edhe pas shqyrtimit te infomacionit te paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo eshte e rregullt ne te gjitha elementet e saj". Dhe ne nenin 66 pika 5 te VKM nr.914 date 29.12.2014 per "Miratimin e rregullave te Prokurimit Publik", i ndryshuar parashikon se "Pas korrjigimit te gabimeve aritmetike, komisioni

i vleresimit te ofertave verifikon nese ofertat e vlefshme jane ose jo me cmirn anomalisht te ulet sipas formulas se percaktuar ne dokumentet standarde te tenderit. Perllogaritja e ofertes anomalisht te ulet behet ne menytrat e meposhtrene: Ne rastin kur jane te vlefshme dy ose me pak oferta, ne perputhje me nenin 56 te LPP, oferta vleresohet anormalisht e ulet kur ajo eshte ulur me shume se 2 % e fondit limit te perllogarithur. Ne rastin kur jane te vlefshme tre ose me shume oferta, ne perputhje me nenin 56 te LPP, oferta vleresohet anomalisht e ulet nese vlere e saj do te jete me e vogel se 85 % e mesatares se ofertave te vlefshme. Nese nje apo disa oferta vleresohen si anomalisht te uleta, komisioni i vleresimit te ofertave duhet te kerkoje sqarime nga ofertuesit, perpara se te marre vendim per kualifikimin ose jo te tyre, ne perputhje me nenin 56 te LPP. Ne cdo rast ofertuesi ka detyrimin te argumentojte dhe te dokumentojte me prova shkresore sqarimet per elementin/elementet e vecanta te ofertes, ne perputhje me kerkesat e nenit 56 te LPP." Nga interpretimi literal i nenit 56 pika 1 te ligjit nr.9643 date 20.1.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar, shoqeria jone konstaton se barra e proves mbi argumentin e ofertes anomalisht te ulet i perket operatorit ekonomik, oferta e te cilit eshte konstatuar nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave dhe ne zbatim te VKM nr.914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", ndryshuar. Gjithashtu, shoqeria jone gjykon se argumentimi i ofertes anomalisht te ulet njeherazi duhet te plotesoje kater kushte kumulative per ti dhene garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor:

Se pari, operatori ekonomik duhet te dorezoje ne menyre te detajuar anen ekonomike te rnetodes se ndertirnit, procesit te prodhimit ose te sherbimeve te ofruara, gjithashtu duhet te paraqese para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike te ofruara si edhe ne raste te vecanta dhe/ose ndonje kusht favorizues te jashtezakonshern, qe ka ofertuesi per kryerjen e punimeve, per furnizimin e mallrave apo te sherbirneve. Gjithashtu eshte detyre e operatoreve ekonomike oferta e te cileve eshte konstatuar anomalisht e ulet te paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor ne lidhje me origjinalitetin e puneve, mallrave apo te sherbimeve, te propozuara nga ofertuesi, si edhe se fundmi duhet te vertetoje zbatueshmerlne e detyrimeve, qe lidhen me mbrojtjen ne pune dhe kushtet e punes, ne vendin ku do te kryhet puna, sherbirni apo ku dote sigurohet furnizimi.

Shoqeria jone gjykon se kushtet e mesiperme te parashikuara nga lex specialis jane kushte kumulative te cilat me ane te provave shkresore dhe argumentimeve perkatese duhen plotesuar nga operoret ekonomike ankimues, oferta e te cileve rezulton anomalisht e ulet. Referuar nenit 56 pika 2 te LPP-se autoriteti kontraktor i verifikon keto elemente duke u keshilluar me ofertuesin dhe ne baze te informacionit te paraqitur Autoriteti kontraktor mund

ta refuzoje oferten, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

Shoqëria jone gjykon se nga interpretimi teleologjik i normës së mesiperme (qellimi i saj) lidhet drejtperdrejtë me shmangien e rrishtit që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët. Shoqëria jone, gjykon se rrishtit që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime ku ndër të tjera si: rrishtit për mos kryerjen e mallit/sherbimit/punëve në cilësinë e duhur; rrishtit i terheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i linden autoritetit nga mos kryerja e furnizimit të mallit brenda afatëve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pesojnë në kohë nga mos kryerja e furnizimit të mallit gjatë periudhës së ri publikimit të procedurës së tenderit në rast të mos zbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilat rezulton anomalisht e ulët, Gjithashtu thekson se referuar nënigj 1 germa "b" "Objekti dhe qellimi" i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se "Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore të sigurojë mirepërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; Mirepërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave me të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar nënigj 1 me të ulët"), por gjithashtu shmangien e rrishtit dhe deshtimit të kontratës që mund të vijë nga oferta të cilat si anomalisht të ulëta, referuar nënigj 1 se përlogaritjes të parashikuar në ligj."

II.4. Nëpërmjet shkresës nr. 3028/4 prot., datë 02.09.2019 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit duke e refuzuar ankesën si vijon:

"[...] Me shkresën nr. 2408/6 prot., datë 26.08.2019 operatori "FEDOS" sh.p.k ka paraqitur argumentet për ankesën ekonomike të ofertës ekonomike bashkëlidhur me faturat tatimore, cmimet e produkteve, kostot e transportit, shpenzimet administrative etj.

Sa më sipër ka rezultuar se oferta e "FEDOS" sh.p.k është e vlefshme.

Gjithashtu KSHA gjatë shqyrtimit të dokumentacionit teknik ligjor, ka konstatuar se oferta e paraqitur nga operatori juaj "BIOCHEM NRP" shpk, nuk përmban shumatorën e cmimeve për njësi, të përcaktuara shprehimisht në formularin përkatës, por ka vetëm cmimet për njësi të secilit prej artikujve të këtij loti, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 6 datë 16.01.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik "Për përdorimin e Marreveshjes Kuader dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" të ndryshuar si dhe rekomandimin nr. 10419 prot, datë 26.11.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik mbi përdorimin e Marreveshjes Kuader."

II.5. Në datën 11.09.2019, operatori ekonomik ankimesit ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt si edhe në autoritetin kontraktor.

II.6. Në datën 23.09.2019 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1484/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 3028/7 prot., datë 19.09.2019, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e shoqërisë “Biochem NRP” sh.p.k se: “[...] *Kundershtojme kualifikimin e operatorit ekonomik FEDOS shpk sepse ky operator ka dorezuar oferte anomalisht te ulet [...]*”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dorëzuar pranë KPP me shkresën nr.3028/7 prot datë 19.09.2019 protokolluar me tonën me nr.1484/2 prot datë 23.09.2019 me objekt “*Informacion sqarues ...*” rezulton se në datën 22.08.2019 autoriteti kontraktor i ka kërkuar operatorit ekonomik “Fedos” shpk shpjegime mbi ofertën anomalisht të ulët me përmbajtje si më poshtë:

“Bazuar ne Ligjin nr.9643 dt. 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" (i ndryshuar), neni 56, per Proceduren e Prokurimit me objekt: "Blerje materiale mjekesore per Sherbimin e Laboratorit te Mikrobiologjise ne QSUT per vitet 2019-2020, e ndare ne Lote, Loti 3: Hemokultura me Ref-29386-07-04-2019, rezulton se Oferta juaj eshte Anomalisht e ulet.

Sipas percaktimit te bere ne nenin 66 te Kreut VII te RrPP, nese oferta e dorezuar, rezulton anomalisht e ulet ne lidhje me mallrat e ofruara, atehere Autoriteti Kontraktor i kerkon Ofertuesit ne fjale te justifikojte cmimin e ofruar. Nese Ofertuesi nuk arrin te jape nje justifikim qe te binde Autoritetin Kontraktor, atehere ky i fundit ka te drejte te refuzoje oferten.

Sa me siper, keni detyrimin te argumentoni dhe dokumentoni me prova shkesore sqarimet mbi elementin/elementet e vecante te ofertes Tuaj ne perputhje me kerkesat e nenit 56 te LPP, brenda dt.26.08.2019 ora 9:00, ne te kundert oferta juaj do te refuzohet, konform ligjit ne fuqi.”

III.1.2. Me datë 26.08.2019, me shkresën nr.23 prot operatori ekonomik “Fedos” i ka kthyer përgjigje autoritetit kontraktor mbi argumentimin e ofertës anomalisht të ulët të paraqitur prej tij, shoqëruar me dokumentacion provues të kostove të blerjes së artikujve dhe shpenzime të tjera.

III.1.3. Në shtojcën 12 “Sasia dhe grafiku i lëvrimit”, të dokumentave të mësipërme të prokurimit, rezulton se nga an e autoritetit kontraktor është parashikuar si më poshtë vijon:

“Loti 3: Hemokultura

<i>Loti 3: Hemokultura</i>			
<i>Nr</i>	<i>Emertimi artikullit</i>	<i>Njesia</i>	<i>Sasia</i>
<i>1</i>	<i>Shishe hemokulture aerobike per te rritur</i>	<i>Shishe</i>	<i>6 000</i>
<i>2</i>	<i>Shishe hemokulture aerobike per femije</i>	<i>Shishe</i>	<i>1 500</i>
<i>3</i>	<i>Shishe hemokulture anaerobike per te rritur</i>	<i>Shishe</i>	<i>100</i>
<i>4</i>	<i>Shishe hemokulture anaerobike per femije</i>	<i>Shishe</i>	<i>100</i>

	TOTALI pa TVSH		
	TVSH		
	TOTALI me TVSH		

PS : Per te gjithë zerat e preventivit te cilet nuk kane nje emertim te përshtatur ne shqip por vetem ne anglisht OE te interesuar do ti referohen emertimit ne anglisht per arsye se nuk eshte e mundur përshtatja ne shqip e emertimit te sakte nga gjuha angleze pasi sjell si pasoje keqkuptim dhe konfuzion mbi llojin e materialit apo artikullit qe kërkohet ne te vertete nga AK

Shenim: Ofertuesi duhet te perfshije ne oferten e tij sasite e pritshme ,çmimin per njesi dhe vleren e pritshme e kontrates per lotin qe oferton

Kontratat do te jepen brenda periudhës: nga momenti i lidhjes se Marrëveshjes Kuader me OE shpallur fitues për secilin lot, me afat perfundimtar 12 muaj nga data e nënshkrimit të MK për secilin lot.

QSUT do të lidhë kontratë në bazë të nevojave të saj në çdo 4 mujor. Perjashtimisht ketij percaktimi, autoriteti kontraktor mund të lidhin kontratë për çdo nevojë për materiale mjekesore që del e paparashikuar dhe është e domosdoshme në cdo kohë.

Afatet e lëvrimit:

Per çdo kontrate të lidhur sipas percaktimit më sipër afatet e lëvrimit do te jene si me poshte:

- 15% e mallit për secilin material, kit, reagent, konsumabël duhet të lëvrohet maksimumi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës dhe pjesa tjetër sipas kërkesave të Shërbimit të Laboratorit të Mikrobiologjisë dhe Drejtorisë së Shërbimit Farmaceutik.”

III.1.4. Në nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon se “[...] 1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj[...].”

III.1.5. Në nenin 66 pika 5 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikon se “Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës

anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur. Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni I vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP. [...]”

III.1.6. Nga interpretimi literal i nenit 56 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe në zbatim të VKM 914/2014. Gjithashtu, K.P.P. gjykon se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor. Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të ofruara si edhe në raste të veçanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi, si edhe së fundmi duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. K.P.P. gjykon se katër kushtet e mësipërme të parashikuara nga lex specialis janë kushte kumulative të cilat më anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë ankimues, oferta e të cilëve rezulton anomalisht e ulët. Referuar nenit 56 pika 2 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. K.P.P. gjykon se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangjen e riskut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët. K.P.P. gjykon se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime ku ndër të tjera si: rreziku për mos kryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i lindin autoritetit nga mos kryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga mos kryerja e shërbimit gjatë periudhës së ri publikimit të procedurës së tenderit në rast të mos zbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, K.P.P. thekson se referuar nenit 1 gërma “b” “Objekti dhe qëllimi” i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet

kontraktore të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi ofertën ekonomike të operatorit ekonomik “Fedos” sh.p.k., dhe nga ky verifikim rezultoi se, nga ana e këtij të fundit është paraqitur oferta ekonomike, plotësuar sipas zërave të kërkuara nga autoriteti kontraktor.

Nga llogaritjet e kryera nga Komisioni i Prokurimit Publik, referuar bazës ligjore si më sipër cituar rezultoi se oferta e operatorit ekonomik “Fedos” sh.p.k., është anomalisht e ulët dhe sipas informacionit të autoritetit kontraktor, rezultoi se edhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave e ka konstatuar këtë fakt, dhe ka kërkuar që nga operatori ekonomik të paraqiten argumentimet dhe dokumentacioni me prova shkresore mbi elementin/elementet e vecante të ofertes.

Nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor rezultoi se nga ana e operatorit ekonomik “Fedos” sh.p.k., me synim justifikimin/argumentimin e ofertës anomalisht të ulët është dorëzuar dokumenti, datë 26.08.2019 me objekt: “Argumentim për ofertën anomalisht të ulët” me sqarimet përkatëse për çmimet e ofertës së paraqitur prej tij, shoqëruar me dokumentacion provues. Kështu është paraqitur dokumenti lëshuar nga kompania “Autobio Diagnostics co” Ltd Kinë, drejtuar shoqërisë “Fedos” sh.p.k në të cilën jepet informacion për ofertën e kësaj shoqërie, lidhur me artikujt objekt prokurimi, aparatit dhe trajnimit, shërbimet me cmimet përkatëse, si konfirmimet e pagesave lidhur me transportin. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Fedos” sh.p.k në mbështetje të ofertës së paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, rezultoi se ky i fundit është konform kërkesave të përcaktuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, pasi shoqëria në fjalë ka paraqitur dokumentacion mbështetës dhe provues si oferta e dhënë nga shoqëria “Autobio” Kinë, përgjigjet e kërkesës për ofertë të transportit të ngarkesave, ku rezultojnë cmime me vlerë më të ulët se ato të ofruara në ofertën ekonomike të kësaj shoqërie, ofertuar në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Gjithashtu në shkresën drejtuar autoritetit kontraktor Fedos shpk ka paraqitur analizën e plotë të cmimit për cdo artikujt e ofruar, duke e argumentuar vlerën e ofertuar prej tij. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e operatorit ekonomik – oferta e të cilit në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacion ka rezultuar anomalisht e ulët, janë paraqitur sqarime dhe dokumentacion i plotë që argumentojnë ofertën anomalisht të ulët (në kuptim të: metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushte përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar), duke krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

KPP sqaron se është detyrim i operatorëve ekonomikë që në rast të shpalljes fitues t’i përmbahen zbatimit të kontratës duke ofruar shërbime/punë/mallra me të njëjtin cilësi të kërkuara në dokumentet e procedurës së prokurimit dhe me të njëjtën ofertë ekonomike të propozuar. Në bazë të nenit 62 “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës” të LPP, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit

publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t'u siguruar nëse cilësia e mallit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të nenin 62 të LPP-së, si më sipër cituar.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Biochem NRP” sh.p.k., për procedurën e prokurimit me Nr.REF-29386-07-04-2019, me objekt: *“Hemokultura”*, Loti 3, me fond limit 4 104 500 lekë pa tvsh, zhvilluar ne daten 29.07.2019 nga autoriteti kontraktor Qendra Spitalore Universitare “Nene Tereza”..
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1484 Protokolli

Datë 11.09.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha